



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 483/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Vllastimir Dimic dhe Ferid Osmani anëtarë, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja e cila i drejtohet Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 14.12.2010, mori:

VENDIM

Hidhet poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar ankesë nga subjekti politik LVV, e cila i drejtohet KQZ-së, pasi me date 12.12.2010 në Shkollën Filllore “Ismail Qemajli” Prishtinë, në QV 1911e që nga hapja e VV në ora 07:00 e deri 10:15 nuk janë punuar llambat identifikuese, ndërsa votuesit kanë votuar.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale, me propozim që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur kundrejt KQZ-se është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe rregullimin e llampave identifikuese, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 483/2010 më datën 14.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

